



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 71

---

Tiranë – E enjte, 6 prill 2017

---

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 29.3.2017	Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave..... 4325



**VENDIM**  
**Nr. 277, datë 29.3.2017**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT**  
**KOMBËTAR TË FREKUENCAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 9, dhe 63, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 3, të nenit 22, të ligjit nr. 97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Administrimi dhe përdorimi i frekuencave bëhet sipas përcaktimeve të Planit Kombëtar të Frekuencave.

3. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive, të vënë në dispozicion të publikut, në formë elektronike, gjendjen e brezave që kanë në administrim.

4. Brezat e frekuencave që administrohen nga dy ose më shumë institucione rregullohen me marrëveshje ndërmjet tyre.

5. Vendimi nr. 466, datë 27.2.2013, Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Niko Peleshi**